



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

PROJEKT LIGJ  
Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.2020

**PËR REGJISTRIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
V E N D O S I:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

**Objekti i ligjit**

Ky ligj përcakton procedurat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, si dhe rregullat për mbajtjen e regjistrit të tyre.

Komente/Sugjerime

Sugjerojmë që të shtohet edhe një nen për qëllimin e ligjit dhe të plotësohet më mirë objekti i tij. Po ashtu, duhet të ketë një referencë ligjore se çfarë kuptohet me OJF për hatër të këtij ligji – sipas Ligjit nr.8781.

Neni 2

**Përkufizime**

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Dokumentet shoqëruese” janë dokumente, të cilat provojnë të dhënat që regjistrohen.
- b) “Kërkesë për regjistrim” është kërkesa që i drejtohet Sekretarisë së Regjistrimit për kryerjen e veprimeve në regjistër, sipas këtij ligji.

c) “Kërkues” është organizata jofitimprurëse, të cilit i përkasin të dhënat që regjistrohen, njoftohen ose depozitohen në regjistër, apo personat e tjerë që, sipas këtij ligji, kanë të drejtë të kërkojnë kryerjen e veprimeve në regjistër.

ç) “Ministri” është ministri që mbulon çështjet e drejtësisë.

d) “Mjet elektronik” është çdo mjet, me anë të të cilit mundësohen dërgimi fillestar i informacionit e marrja e tij nga marrësi i përcaktuar me anë të pajisjeve elektronike për përpunimin (duke përfshirë ngjeshjen shifrore) dhe ruajtja e të dhënave, tërësisht të transmetuara, të përcjella apo të marra përmes kablove, valëve radio, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike.

dh) “Organizatave jofitimprurëse” ka të njëjtin kuptim si në ligjin për organizatat jofitimprurëse, të cilat kanë detyrimin e regjistrimit, sipas këtij ligji.

e) “Regjistri elektronik” është regjistri i organizatave jofitimprurëse i cili krijohet dhe administrohet si një bazë të dhënash shtetërore, në të cilin regjistrohen organizatat jofitimprurëse, sipas këtij ligji.

ë) “Regjistrim fillestar” është regjistrimi për herë të parë në regjistër.

f) “Regjistrim tjetër” është çdo ndryshim, shtesë apo fshirje të dhënash në regjistër.

g) “Regjistrim” është regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër, përfshirë dhe çregjistrimin e subjektit nga regjistri.

gj) “Sporteli elektronik” është portali elektronik i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i aksesueshëm nëpërmjet faqes zyrtare në internet, ku mundësohet ofrimi i shërbimit për publikun në distancë, duke komunikuar drejtpërdrejt me sistemin qendror të për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, nëpërmjet mjeteve elektron

h) “Të dhëna” janë faktet, aktet dhe informacionet që regjistrohen, njoftohen apo depozitohen në regjistër.

#### Komente/Sugjerime

Neni 2, pika 1, gërma d, jepet përkufizimi i mjetit elektronik. A është dhe telefoni pjesë e kësaj kategorie? Nëse po, është e nevojshme të përfshihet.

Neni 2, pika 1, gërma dh, jepet përkufizimi i organizatave jofitimprurëse. Ashtu si dhe në komentimin më lart në nënin 2, është e nevojshme të specifikohet dhe të ketë një referencë ligjore se çfarë kuptohet me OJF për hatër të këtij ligji – sipas Ligjit nr.8781.

Neni 2, pika 1, gërma gj, jepet përkufizimi i sportelit elektronik dhe specifikohet që përmes tij mundësohet ofrimi i shërbimit për publikun në distancë. Nuk është e qartë nëse përfshin dhe kryerjen e pagesës online, përkufizimi i saj, është e rëndësishme të specifikohet dhe përfshihet dhe më poshtë si pjesë e neneve se si do të funksionojë.

## KREU II REGJISTRI I ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE

### SEKSIONI I REGJISTRI DHE EFEKTET E REGJISTRIMIT DHE TË PUBLIKIMIT

### Neni 3

#### **Regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse**

1. Regjistri elektronik i Organizatave Jofitimprurëse është një bazë e të dhënave shtetërore, përmes së cilës grumbullohet informacioni i organizuar dhe ruajtur në formë elektronike për organizatat jofitimprurëse, ku përpunimi dhe përditësimi i tij kryehet përmes sistemit kompjuterik. Informacioni përbëhet nga dosje të veçanta elektronike për çdo organizatë jofitimprurëse që ka detyrimin e regjistrimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Regjistri elektronik i Organizatave Jofitimprurëse krijohet dhe mbahet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Të gjitha të dhënat, kërkesat për regjistrim dhe dokumentet shoqëruese, pavarësisht nëse janë paraqitur në formë shkresore apo elektronike, sipas këtij ligji, regjistrohen dhe ruhen në regjistër në formë elektronike.

3. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave, të njoftuara dhe të depozituara në regjistrin elektronik, kryhen nëpërmjet një sistemi të informatizuar, sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj.

4. Pjesë përbërëse e regjistrit janë edhe dokumentet e depozituara në anekset e tij, sipas këtij ligji.

#### Komente/Sugjerime

Për krijimin e regjistrit elektronik ka nevojë për protokoll veprimesh të bazuar në një dokument zyrtar ku edhe shoqëria civile të ketë mundësi të informohet për sigurinë e mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave dhe qëllimin e përdorimit të tyre.

Neni 3, pika 2, është e paqartë si trajtohet dhe mundësohet siguria e këtij informacioni, duke marrë parasysh që do të mbahet vetëm elektronikisht?

Neni 3, pika 3. Me zhvillimet ligjore për komunikimet elektronike, është e nevojshme të shihet e vlerësohet si lidhet kjo pikë dhe ligji, me ligjin për komunikimet elektronike. Duhet parë dhe nëse bëhet fjalë për faqen ekzistuese të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, apo do krijohet diçka e re (që do ketë kosto dhe se dimë sa e gatshe do jetë Gjykata për ta bërë në kohë).

### Neni 4

#### **Të dhënat që regjistrohen**

Regjistri elektronik përmban të dhëna, që i përkasin themelimit, veprimtarisë dhe çregjistrimit të organizatave jofitimprurëse, çdo ndryshim në status dhe organizimin e subjektit, të dhëna, që i përkasin atij në lidhje me përfaqësimin, si dhe të dhëna të tjera, të parashikuara me ligj.

#### Komente/Sugjerime

Në nenin 4, përcaktohet që në regjistrin elektronik permbahen dhe të dhëna të tjera (përveç atyre që janë përmendur specifikisht), është e paqartë se kush janë këto të dhëna të tjera.

Në Projektligj duhet të ketë një listë shteruese të të dhënave të domosdoshme në funksion të regjistrimit dhe funksionimit të OJF-ve. Ashtu siç është përcaktuar në këtë pikë le hapësirë për abuzime.

### Neni 5

#### **Mënyra e regjistrimit**

1. Regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër kryhet nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për regjistrim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kërkesa për regjistrim paraqitet me shkresë ose

në formë elektronike, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Ministri i Drejtësisë miraton me udhër formularët e kërkesave për regjistrim, për çdo regjistrim që kryhet në regjistër, si dhe listën e dokumenteve shoqëruese për çdo regjistrim, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

#### Komente/Sugjerime

Neni 5, pika 2, është e nevojshme të specifikohen saktë referencat ligjore sepse edhe nga teknika legjislative nuk lejohen referencat e përgjithshme.

### Neni 6

#### **Efektet e regjistrimit dhe të publikimit**

1. Çdo e dhënë, e regjistruar dhe e publikuar në regjistrin elektronik, sipas dispozitave të këtij ligji, prezumohet se i është njoftuar çdo palë të tretë nga dita e publikimit, sipas nenit 37 të këtij ligji.

2. Pavarësisht nga parashikimi i pikës 1, jo më shumë se pesëmbëdhjetë ditë nga data e publikimit, pala e tretë nuk prezumohet që ka marrë dijeni për të dhënat e regjistruara dhe të publikuara në regjistër, kur provon se e kishte të pamundur të merrte dijeni, duke treguar të gjithë kujdesin e zakonshëm.

3. Kur të dhënat janë regjistruar ose publikuar në mënyrë të pasaktë në regjistrin elektronik, prezumohet që këto të dhëna nuk i janë njoftuar palëve të treta. Pavarësisht këtij parashikimi, prezumohet që pala e tretë ka marrë dijeni, pavarësisht se të dhënat janë regjistruar ose publikuar në mënyrë të pasaktë në regjistrin elektronik, kur provohet se pala e tretë kishte dijeni për pasaktësinë e të dhënave të publikuara ose për të dhëna të tjera të papublikuara.

4. Çdo palë e tretë mund t'i kundrejtojë organizatës jofitimprurëse të dhënat e regjistruara e të publikuara, edhe nëse këto të dhëna janë të pasakta, përveç rastit kur organizata provon se i treti kishte dijeni për pasaktësinë e të dhënave të publikuara ose për të dhëna të tjera të papublikuara.

5. I treti mund t'i kundrejtojë organizatës të dhëna ende të papublikuara kur, pavarësisht mospublikimit, i treti kishte dijeni për këto të dhëna, me përjashtim të rastit kur, sipas ligjit, mospublikimi nuk sjell pasoja.

6. Regjistrimet e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse vlerësohen gjithnjë të njohura dhe përbëjnë akt zyrtar për autoritetet publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Komente/Sugjerime

Neni 6, pika 2, lidhur me përcaktimin për palën e tretë, kur provon se e kishte të pamundur të merrte dijeni. Kjo është një çështje delikate në kuptimin e këtij ligji dhe nuk mund të mbetet kaq evazive pasi le vend për interpretim dhe penalitete.

Neni 6, pika 3, nuk na duket korrekte që pasi mbaron procedura e publikimit të të dhënave të flasim për prezume për pasaktësinë e tyre. Nga momenti i publikimit ato duhen marrë të mirëqena se janë të sakta dhe në të kundërt veprojnë ligje të tjera për deklarim të dhënash të rreme dhe përgjegjësia mbahet nga deklaruesi. Kjo pikë është e paqartë dhe ka nevojë për saktësime edhe në pika të tjera.

Neni 6, pika 3 përcakton, kur provohet se pala e tretë kishte dijeni për pasaktësinë e të dhënave të publikuara ose për të dhëna të tjera të papublikuara. Është e paqartë kujt i lind barra e provës dhe si bëhet kjo në gjykatë? Do zhvillohet një procedurë për këtë gjë?

Neni 6, pika 4, është i paqartë termi “kundrejtojë”, cili është kuptimi?

SEKSIONI II  
DETYRIMI PËR REGJISTRIM, RREGULLAT E EMËRIMIT, PERSONAT E AUTORIZUAR DHE  
FORMA E AKTEVE SHOQËRUESE

Neni 7

**Detyrimi për regjistrim**

1. Organizatat jofitimprurëse që detyrohen të regjistrohen sipas këtij ligji janë shoqatat, fondacionet dhe qendrat si dhe çdo subjekt tjetër, i cili me ligj të veçantë detyrohet të regjistrohet pranë Regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse.

2. Organizatat jofitimprurëse janë të detyruara të paraqesin kërkesën për regjistrim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e themelimit, por, në çdo rast, përpara datës së fillimit të ushtrimit të veprimtarisë.

3. Për regjistrimet e tjera të detyrueshme, përveç rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe, aplikimi bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës faktike dhe/ose e hartimit të aktit të detyrueshëm për t'u regjistruar.

Komente/Sugjerime

Neni 7, pika 1, është e nevojshme për shumë arsye që OJF-të sipas kuptimit të Ligjit 8781 të jenë të ndara në këtë regjistër nga subjektet e tjera jofitimprurëse si psh, partitë politike. Kjo do të siguronte një info më të saktë mbi sektorin, peshën e tij, transparencën por lidhje organike me pjesen tjetër të kuadrit ligjor e rregullator për OJF-të.

Në këtë pikë drafti krijon paqartësi se kë ka në fokus.

Neni 7, pika 3, cili është detyrimi që ka gjykata për të njohur marrjen e aplikimit për regjistrim? Kjo është e nevojshme për t'u saktësuar pasi sjell tejzgjatje të procesit duke e rikthyer të gjithë procesin. Cili është detyrimi që ka gjykata për të marrë një vendim? Është e nevojshme për të patur një afat ligjor ose edhe regjistrim automatik nëse gjykata nuk përgjigjet brenda afateve. Kjo është një praktikë që është futur në vend për një seri rastesh.

Neni 8

**Rregullat e emërimit**

1. Ndalohet regjistrimi në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse i organizatave me emra të njëjtë ose të ngjashëm, me emra në trajtën e shquar apo shkurtimet përkatëse të shteteve, qyteteve, krahinave gjeografike, organizatave ndërkombëtare, fetare ose institucioneve të pushtetit qendror apo vendor, pa shtesa dalluese ose me emra, që janë në kundërshtim me rendin e moralin publik apo me dispozitat urdhëruese të ligjit.

2. E drejta për të regjistruar emrin njihet në bazë të parimit të përparësisë së paraqitjes së kërkesës për regjistrim në Gjykatë.

3. Ministri i Drejtësisë, me udhëzim miraton rregullat për emrat dhe emërtimet e organizatave jofitimprurëse.

Komente/Sugjerime

Neni 8, pika 3, është çështje e së drejtës së organizimit dhe mund të përbëjë shkak për mos regjistrim, prandaj duhet të jetë e përcaktuar në ligj dhe jo të rregullohet me urdhër Ministri.

## Neni 9

### Personat e autorizuar për të bërë regjistrimin

1. Kërkesa për regjistrimin fillestar të organizatave jofitimprurëse mund të paraqitet bashkërisht nga të gjithë themeluesit, nga organi ekzekutiv që ka të drejtën e përfaqësimit të organizatës me të tretët ose nga çdo person i autorizuar prej tyre. Kërkesa për regjistrimet e tjera paraqitet nga organi ekzekutiv që ka të drejtën e përfaqësimit të organizatës me të tretët ose nga çdo person i autorizuar prej tyre.

2. Kërkesa për regjistrim fillestar dhe regjistrimet e tjera të organizatave jofitimprurëse të huaja bëhet nga përfaqësuesi ligjor i degës ose i organizatës jofitimprurëse të huaj apo nga çdo person i autorizuar nga njëri prej personave të përmendur më sipër.

3. Në çdo rast, të drejtën për të kërkuar regjistrimin fillestar apo regjistrimet e tjera e ka edhe çdo person tjetër që ligji i posaçëm i ka njohur këtë të drejtë.

#### Komente/Sugjerime

Neni 9, pika 3, është e paqartë çfarë nënkupton ligji i posaçëm? Kujt i referohet?

## Neni 10

### Kërkesa për regjistrim dhe forma e dokumenteve shoqëruese

1. Regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër kryhet nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për regjistrim, sipas formularit përkatës, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresë ose në formë elektronike. Kërkesës për regjistrim i bashkëlidhen dokumentet shoqëruese, që provojnë të dhënat që regjistrohen.

2. Dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohen në origjinal ose në kopje të panjësuar me origjinalin dhe të jenë hartuar sipas formës dhe mënyrë së përcaktuar nga legjislacioni përkatës apo nga dispozitat e këtij ligji. Dokumentet shoqëruese mund të dorëzohen edhe në format elektronik, sipas parashikimeve të kreut VI. Dorëzimi i dokumentit shoqërues pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në kopje të panjësuar apo në format elektronik bëhet nën përgjegjësinë e plotë të personit që e paraqet atë, i cili, nëpërmjet aktit të dorëzimit, konfirmon njësinë e kopjes apo të dokumentit në formë elektronik me origjinalin.

3. Dokumentet shoqëruese nuk duhet të përmbajnë korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe përmbajtja e tyre duhet të duket qartë, të jetë e lexueshme dhe të lejojë marrjen e imazhit elektronik të dokumentit.

4. Dokumentet shoqëruese duhet të jenë në gjuhën shqipe. Kërkuesi, së bashku me dokumentin shoqërues në shqip, mund të depozitojë edhe përkthimin e vërtetuar në gjuhë të huaj. Shkresat private dhe dokumentet zyrtare të juridiksioneve të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe dhe të legalizohen sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

#### Komente/Sugjerime

Neni 10, pika 2, përcakton që dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohen në origjinal ose në kopje të panjësuar. Mos njesimi i dokumenteve mund të krijojë probleme. Është kontradiktor fakti që dokumenti shoqërues ka një vlerë të mjaftueshme për t'u rregulluar me një format të përcaktuar, por jo mjaftueshëm për t'u siguruar vërtetësia e tij.

Është e nevojshme të përcaktohet, si kryhet komunikimi elektronik për të gjitha natyrat e regjistrimeve (Me email? Kush është formati i këtyre dokumentëve: ëord, PDF)

Draft ligji paraqet një formë risi (komunikimi elektronik) dhe nuk e trajton fare këtë në draft ligj.

Çfarë nënkupton komunikimi elektronik për hatër të këtij ligji dhe si lidhet ai me ligjin për komunikimin elektronik?

Po në këtë nen, përcaktohet se si bëhet dorëzimi i dokumentit shoqëruar. Dorëzimi i dokumentave nga çdokush, siç lexohet në këtë nen, dhe jo i deleguar nga përfaqësuesi ligjor, le vend për abuzim dhe keqpërdorim nga palë të treta.

Neni 10, pika 4, përcakton që dokumentat në shqip mund të jenë të panjesuara, në një kohë që janë bazë për vendimin dhe gjuha e huaj duhet e njesuar. Ka një diskrepancë midis rasteve të regjistrimeve lokale dhe atyre të huaja përse i përket njësimi të dokumentave që nxjerr në pah problematikën e kësaj kërkesë/lirie.

### SEKSIONI III REGJISTRIMI FILLESTAR

Neni 11

#### **Aktet për regjistrimin fillestar**

1. Organizatat jofitimprurëse regjistrohen në regjistrin elektronik, duke depozituar kërkesën për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, statutin dhe aktin e themelimit, aktet e emërimit të organeve vendimarrëse, nëse nuk përfshihen në aktet e mësipërme, si dhe aktet e tjera të nevojshme për themelimin, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Në rastin e fondacioneve që themelohen në bazë të një akti testamentar, bashkë me kërkesën për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, depozitohet testamenti dhe statuti, në rastet kur është hartuar dhe miratuar nga ekzekutori i testamentit.

3. Degët e organizatave jofitimprurëse të huaja, përveç përmbushjes së kërkesave të tjera të legjislacionit në fuqi, regjistrohen duke depozituar kërkesën për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji si dhe:

a) aktin e themelimit e statutin e organizatës jofitimprurëse të huaj, kur këto janë dy dokumente të veçanta apo, në mungesë, aktin ekuivalent të krijimit, sipas legjislacionit të huaj, si dhe tekstin e plotë të tyre me ndryshimet e mëpasshme;

b) dokumentacionin, që vërteton regjistrimin e organizatës jofitimprurëse të huaj në juridiksionin e huaj;

c) dokumentacionin, që vërteton gjendjen aktuale të organizatës jofitimprurëse të huaj, të lëshuar brenda një afati jo më shumë se 90 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës, me të dhënat e regjistrimit dhe të përfaqësimit, përfshirë informacionin nëse është në proces likuidimi apo falimentimi;

ç) bilancin e organizatës jofitimprurëse të huaj për vitin e fundit financiar, mbajtur sipas standardeve të kërkuara në shtetin e huaj, nëse organizata e huaj ka pasur veprimtari për më shumë se një vit;

d) vendimin ose aktet e tjera të organit kompetent të organizatës jofitimprurëse të huaj, sipas legjislacionit të huaj për hapjen e degës në Shqipëri.

#### Komente/Sugjerime

Neni 11, pika 2, është e paqartë si adresohet për fondacionet kërkesa ligjore e një fondi minimum para krijimit? Kodi civil kërkon deklarimin e burimit të pasurisë duke pasur parasysh natyrën specifike të fondacioneve (Neni 55). Deri tani kjo shumë ka qenë e papërcaktuar, por në praktikë gjykata ka kërkuar një fond garancie deri në 100,000 ALL.

Neni 11, pika 3, referuar gërmës c, sa e lehtë do të ishte kjo? Është e paqartë se çfarë do të thotë informacion në këtë rast: dokument nga ndonjë agjenci përgjegjëse në vendin e origjinës, apo thjesht një deklaratë nga organizata?

Çfarë ndodh në rastet kur organizata do të likujdohet në vendin e origjinës dhe të zhvendoset në Shqipëri? Si lidhen këto dy procese me njëri-tjetrin?

Përdorimi i termit “faliment” nuk ka kuptim kur flasim për organizata jofitimpruese.

Neni 11, pika 3, gërma ç, është e paqartë kush është arsyeja e dorëzimit të bilancit? Nëse nuk është për të shqyrtuar shëndetin e institucionit (është në tagrin dhe kopetencën e gjykatës që ta bëjë) atëherë përse kërkohet?

Nga ky nen dhe në këtë ligj janë shfyqizuar të gjitha regjistrimet afat shkurtra për hatër të veprimtarisë së përkohshme apo me afat, siç janë tipikisht programet e ndihmës së huaj të zbatuara nga OJF-të e huaja. Drafti nuk përcakton më se kujt i lind për detyrim regjistrimi në gjykatë.

## Neni 12

### **Organizatat jofitimprurëse me themelues të huaj**

Në rastet e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse me themelues një person juridik të huaj, përveç dokumenteve të kërkuara sipas formës së organizatës jofitimprurëse, kërkesës për regjistrim fillestar i bashkëlidhen edhe dokumentet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “d” të pikës 3 të nenit 11 të këtij ligji, për personin juridik të huaj.

## Neni 13

### **Të dhënat e detyrueshme për organizatat jofitimprurëse**

1. Për regjistrimin fillestar të organizatave jofitimprurëse janë të detyrueshme këto të dhëna:
  - a) emri;
  - b) forma;
  - c) data e themelimit;
  - ç) të dhënat e identifikimit të themeluesve;
  - d) selia;
  - dh) qëllimi dhe fusha e veprimtarisë;
  - e) kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;
  - ë) anëtarët e organeve drejtuese, duke dhënë në çdo rast emrin, mbiemrin, vendlindjen dhe datëlindjen e tyre;
  - f) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre;
  - g) në rastin e fondacionit: përbërja dhe vlera pasurore e fondit themelues;
  - gj) specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë organizatën jofitimprurëse përpara të tretëve.

### Komente/Sugjerime

Neni 13, përcakton të dhënat e detyrueshme për regjistrim të organizatave jofitimprurëse. Si përmbushet ky detyrim? Duket sikur bëhet fjalë më shumë për të dhëna të detyrueshme që do të jenë në regjistër sesa të dhëna që duhet të dorëzohen nga OJF-të. Në çdo rast formatet do të aprovohen nga



Ministri çka nënkupton që Ministri të sigurohet që këto të dhëna janë pjesë e kërkesës për informacion në formatet e aprovuara.

Neni 13, në pikën 1, gërma f përcaktohen “të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë”. Duhet zëvendësuar termi “shoqërisë” me “organizatës”. Përdorimi i përsëritur i termave të biznesit na bën të kuptojmë se hartuesit e projektligjit i shikojnë OJF-të si biznese ashtu siç ndodh për fat të keq në praktikë. Ky projektligj duhet ta zgjidhë këtë situatë dhe duhet riparë me kujdes e gjithë terminologjia e përdorur.

Neni 13, pika 1, gërma g, në rastin e fondacionit: përbërja dhe vlera pasurore e fondit themelues (njëjtë me komentin për fondacionin, neni 11, pika 2).

#### Neni 14

### **Të dhënat e detyrueshme për degët organizatave jofitimprurëse të huaja**

1. Për regjistrimin fillestar të degëve të organizatave jofitimprurëse të huaja janë të detyrueshme këto të dhëna:

- a) të dhënat e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, dhe “g” të nenit 13 të këtij ligji për organizatat jofitimprurëse të huaja, përfshirë numrin dhe vendin e regjistrimit;
- b) emrin e degës, nëse është i ndryshëm nga ai i organizatës jofitimprurëse të huaj;
- c) kohëzgjatjen e degës, në qoftë se kjo është e përcaktuar;
- d) qëllimin dhe fushën e veprimtarisë së degës;
- dh) selinë e degës;
- e) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e degës në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit;
- ë) specimetet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë degën në marrëdhënie me të tretët.

#### Neni 15

### **Subjektet e tjera**

Në rastet kur ligji i posaçëm parashikon detyrimin për t’u regjistruar në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse, sipas shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 11, të këtij ligji, mënyra e paraqitjes së kërkesës për regjistrimin fillestar dhe të dhënat e detyrueshme për t’u regjistruar nga këto subjekte, sipas seksionit IV, të këtij ligji, përcaktohen nga ligji i posaçëm.

#### Komente/Sugjerime

Neni 15 përcakton, në rastet kur ligji i posaçëm parashikon detyrimin për t’u regjistruar në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse, sipas shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 11, të këtij ligji, ndërkohë që shkronja e, e pikës 1, në nenin 11 nuk ekziston.

#### Neni 16

### **Pasojat e regjistrimit fillestar**

Organizatave jofitimprurëse fitojnë personalitet juridik ditën që vendimi i gjykatës për regjistrimin e saj ka marrë formë të prerë. Me fitimin e personalitetit juridik organizatat jofitimprurëse regjistrohen në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse.

SEKSIONI IV  
REGJISTRIMET E TJERA

Neni 17

**Regjistrimet e tjera të detyrueshme**

1. Çdo organizatë jofitimprurëse, që kryen regjistrimin fillestar, mbart edhe detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjistrin elektronik, sipas seksionit III të këtij ligji.

2. Në rast ndryshimi të aktit të themelimit ose statutit depozitohet edhe teksti i plotë i tyre, që pasqyron ndryshimet e mëpasshme. Për degët e organizatave jofitimprurëse të huaja depozitohet statuti dhe akti i themelimit i organizatës jofitimprurëse të huaj apo dokumenti ekuivalent i krijimit, sipas legjislacionit të huaj, me tekstin e plotë, që pasqyron ndryshimet e bëra.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, organizatat jofitimprurëse duhet të regjistrojnë dhe të depozitojnë aktet përkatëse, si më poshtë:

a) pasqyrat financiare vjetore, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme;

b) emërimin dhe shkarkimin e ekspertit kontabël të autorizuar, në rastet kur emërimi është i detyrueshëm, numrin e licencës profesionale, si dhe të dhënat e tyre të identifikimit;

c) emërimin e likuiduesve, si dhe të dhënat e tyre të identifikimit;

ç) aktet e prishjes, mbylljes apo shpërndarjes, aktet e transformimit, bashkimit, ndarjes, hapjes së procedurave të administrimit, likuidimit ose riorganizimit, si dhe aktet e tjera të ndërmjetme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Për degët e organizatave jofitimprurëse të huaja regjistrohen edhe aktet e transformimit, të bashkimit, ndarjes, hapjes dhe mbylljes së procedurave të likuidimit ose falimentimit të organizatës jofitimprurëse të huaj;

d) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia;

dh) kompetencat e përfaqësimit të organeve drejtuese ose të likuiduesve;

e) emrat, mbiemrat, datëlindjet dhe vlera e kontributeve pasurore të fondit themelues (nëse ka të tilla);

ë) çdo regjistrim tjetër të detyrueshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 17, pika 3, gërma a, Eshte gjykata vendi i vetem ku depozitohen keto pasqyra apo dorezohen njekohesisht edhe ne drejtorine e tatimeve? Cfare ndodh me organizatat qe nuk dorezojne pasqyra por te ardhura dhe shpenzime sipas ligjit te kontabilitetit? Ne parim cdo OJF duhet te dorezoje kete info cdo fund Marsi.

DE\_Pasqyrate financiare nuk ka pse te jene objekt i rregullimit nga ky ligj sepse rregullohen nga ligji organik i OJF-ve dhe ligje te tjera.

Komente/Sugjerime

Neni 17, pika 3, gërma b, nuk ka asnjë detyrim ligjor për OJF-të në këtë drejtim.

Neni 17, pika 3, gërma c, përderisa ndryshimet e akteve kryesore dhe dokumenteve shoqëruese pasqyrohen në regjistër kjo pikë është e tepërt dhe jo për OJF-të por për shoqëritë tregtare dhe biznesin.

Neni 17, pika 3, gërma ç, është e paqartë si trajtohet kjo ceshtje në rastet e bashkimit apo ndarjes së OJF shqiptare (jo degë të huaja)

Neni 17, pika 3, gërma d, është e paqartë se çfarë quhet seli në rastin e një dege OJF të huaj? Zyra në

vendin e origjinës, apo qyteti në Shqipëri ku ndodhet zyra e degës?

Neni 17, pika 3, gërma e, emrat, mbiemrat, datëlindjet dhe vlera e kontributeve pasurore të fondit themelues (nëse ka të tilla), është e paqartë.

## Neni 18

### **Regjistrimet e tjera vullnetare**

Organizatata jofitimprurëse mund të regjistrojnë në regjistrin elektronik çdo të dhënë tjetër, të ndryshme nga të dhënat e përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji, të cilat kanë lidhje me veprimtarinë e tyre. Këto të dhëna shtesë përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

- a) emërtimin ose shenjat e tjera dalluese të veprimtarisë (nëse është/janë i/të ndryshëm nga emri i regjistruar i organizatës jofitimprurëse);
- b) ëeb-site, e-mail, telefon dhe faks;
- c) vendimet e organeve drejtuese të organizatës jofitimprurëse, si vendimet e pezullimit të veprimtarisë apo vendimet e tjera të ndryshme nga vendimet e detyrueshme për regjistrim;
- ç) të dhëna të tjera, të lidhura me veprimtarinë të organizatës jofitimprurëse.

#### Komente/Sugjerime

Neni 18 përcakton: Organizatat jofitimprurëse mund të regjistrojnë në regjistrin elektronik çdo të dhënë tjetër, të ndryshme nga të dhënat e përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji, të cilat kanë lidhje me veprimtarinë e tyre. Është konfuzues “mund të regjistrojnë”, pasi të tre pikat e para përbejnë detyrim ligjor për OJF-të që duhet ti depozitojë. Përndryshe si bëhet identifikimi dhe korrespondenca me to e mbi të gjitha lëshimi i numrit të identifikimit.

Projektligji duhet të ketë rregullime vetëm për një listë shteruese të dokumentacionit të domosdoshëm, ndërsa çdo informacion tjetër nuk duhet të kërkohet ose duhet të lihet në vullnetin e OJF-ve në duan të publikojnë në regjistrin elektronik edhe informacione të tjera për veprimtarinë e tyre.

## Neni 19

### **Regjistrimet me vendim gjyqësor**

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë regjistron në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse dhe publikon, kryesisht ose me kërkesë nga çdo person i interesuar, vendimet gjyqësore për të dhënat e regjistruara ose veprimtarinë e organizatës jofitimprurëse.

2. Kërkesës për regjistrime nga personat e interesuar i bashkëlidhet vendimi përkatës. Regjistrimi kryhet sipas rregullave të përcaktuara në kreun III të këtij ligji.

#### Komente/Sugjerime

Neni 19, pika 1, është e paqartë. Është e nevojshme të sqarohet dhe ndahet pjesa e regjistrimit të informacionit të detyruar në regjistër nga ana e mbajtësve të regjistrit, nga ajo e publikimit të informacionit, pra të asaj çfarë bëhet publike.

Është jo e qartë sesi një person i interesuar (nga publiku, jo OJF) përcakton të dhënat që duhet të futen në regjistër!!!

## Neni 20

### **Çregjistrimi i subjektit**

1. Organizatat jofitimprurëse çregjistrohen nga regjistri elektronik në rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për prishjen dhe pavlefshmërinë e personave juridikë, shpërndarjen e organizatave jofitimprurëse, si dhe në çdo rast tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

2. Çregjistrimi kryhet:

- a) në mënyrë vullnetare me iniciativën e vetë organizatës jofitimprurëse;
- b) në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë;
- c) sipas parashikimit të ligjeve të posaçme.

## Neni 21

### **Çregjistrimi vullnetar**

Kur vendoset shpërndarja nga vetë organizata jofitimprurëse, çregjistrimi nga regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse kryhet vetëm pasi vendimi i gjykatës për çregjistrimin e organizatës jofitimprurëse ka marrë formë të prerë.

## Neni 22

### **Çregjistrimi me vendim gjyqësor**

Në rastet kur gjykata vendos shpërndarjen e organizatës jofitimprurëse, çregjistrimi nga regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse kryhet vetëm pasi vendimi i gjykatës për çregjistrimin e organizatës jofitimprurëse ka marrë formë të prerë.

## Neni 23

### **Të dhënat e subjekteve të çregjistruara**

1. Të dhënat e organizatave jofitimprurëse të çregjistruara mbahen në regjistër, duke vënë shënimin “i çregjistruar”, si dhe numrin e datën e vendimit gjyqësor ose të autoritetit tjetër publik, sipas ligjeve të posaçme, që ka vendosur çregjistrimin nga regjistri. Këto të dhëna ruhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në format elektronik dhe janë gjithnjë të aksesueshme për publikun.

2. Emri i organizatës jofitimprurëse ndalohet të përdoret dhe nuk mund të regjistrohet nga asnjë subjekt tjetër për një afat prej 6 muaj nga data e çregjistrimit.

#### Komente/Sugjerime

Neni 23, pika 2, kjo e drejtë duhet kufizuar për një kohë shumë më të gjatë, pasi mund të sjelli keqpërdorim dhe manipulim të publikut.

Nëse është e mundur të parashikohet në këtë projektligj edhe mbrojtja nga përdorimi i paligjshëm i informacioneve të publikuara nga OJF-të aktive duke e parë edhe në logjikën e të drejtave të autorit që rregullohen me ligj të posaçëm. Këtu kemi parasysh informacione që kanë të bëjnë me emrin, logon, publikime të ndryshme apo edhe deri tek përmbajtja e projekteve.

## Neni 24

### **Pasojat e çregjistrimit**

1. Çregjistrimi i organizatave jofitimprurëse nga regjistri elektronik ka si pasojë humbjen e personalitetit juridik të subjekteve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme.

2. Çregjistrimi nga regjistri i organizatave jofitimprurëse i degëve të organizatave jofitimprurëse të huaja që nuk fitojnë personalitetin juridik nëpërmjet regjistrimit, ka vetëm efekt deklarativ.

3. Subjektet e çregjistruara përgjigjen për detyrimet e mbetura ndaj të tretëve dhe ndaj autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### KREU III ORGANET PËRGJEGJËSE PËR REGJISTRIMIN

#### Komente/Sugjerime

Ky kre nuk është i qartë. Është e nevojshme të qartësohet struktura që do të menaxhojë regjistrimin e OJF-ve. Nuk janë të qarta kompetencat e kancelarit, i janë lënë dhe kompetenca për vendosjen e penalteteve, çka mund të jetë abusive, për më tepër nuk citohet baza ligjore dhe sa janë kompetencat në përputhje me parashikimet ligjore që rregullojnë veprimtarinë e gjyqësorit dhe funksionet e kancelarit.

### SEKSIONI I SHQYRTIMI DHE VENDIMMARRJA

#### Neni 24

#### **Gjyqtari i vetëm**

Vendimi për regjistrimin fillestar të organizatave jofitimprurëse, si dhe vendimi për çrregjistrimin e tyre merret nga një gjyqtar i seksionit tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj.

#### Komente/Sugjerime

A parashikohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të ketë një seksion të veçantë të gjyqtarëve që trajtojnë regjistrimin e OJF-ve?

#### Neni 25

#### **Kancelari**

Vendimi për regjistrimet e tjera, sipas përcaktimit të seksionit IV të Kreut II të këtij ligji, merret nga Kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj.

#### Neni 26

#### **Sekretaria e Regjistrimit Elektronik**

1. Sekretaria e Regjistrimit Elektronik të Organizatave Jofitimprurëse kryen këto funksione:

- a) Kujdeset për mbajtjen dhe administrimin e Regjistrimit Elektronik;
- b) Regjistron dhe mban vendimet e gjyqtarit për regjistrimin fillestar dhe çrregjistrimit dhe të kancelarit për regjistrimet e tjera si dokumentacionin që i bashkëlidhet, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj;
- c) Lëshon vërtetimin e regjistrimit dhe të depozitimit të akteve në Regjistrimin Elektronik, si dhe

vërtetime të tjera në rastet e parashikuara me ligj.

ç) Lëshon kopje të regjistrimit dhe të dokumenteve të depozituara në shtojcat e Regjistrimit Elektronik.

2. Në rastet kur Sekretari i Regjistrimit Elektronik kundërshton të lëshojë një dokument me përmbajtje të ndryshuar nga dokumenti i mëparshëm, kërkesa për lëshimin e tij shqyrtohet nga një gjyqtar i Regjistrimit Elektronik. Kundër vendimit të gjyqtarit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Tiranës.

3. Veprimet për regjistrimin, depozitimin, lëshimin e vërtetimeve, të kopjeve të tyre dhe të akteve që mbahen në Regjistrimin Elektronik kryhen nga Sekretaria e Regjistrimit Elektronik, kundrejt pagesës së tarifave të shërbimit. Tarifat e shërbimit caktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe të Ministrisë të Financave.

#### Komente/Sugjerime

Neni 26, Sekretaria e Regjistrimit Elektronik. Projektligji nuk jep informacion për strukturën e Sekretarisë së Regjistrimit Elektronik që me sa kuptohet është edhe struktura kryesore që do të përballojë volumin e punës përfshirë edhe menaxhimin e sistemit elektronik të përpunimit të informacionit. Është e nevojshme të qartësohet më mirë kjo pikë.

#### Neni 27

#### **Paraqitja e kërkesave**

1. Sekretaria e Regjistrimit Elektronik ndihmon kërkuuesin për plotësimin e kërkesës dhe kryen verifikimet e mëposhtme:

a) identitetin e nënshkruesit dhe faktin nëse është person i autorizuar për të kërkuar regjistrimin;

b) plotësimin e të gjitha të dhënave të detyrueshme të kërkuara, si dhe dokumentet shoqëruese;

c) paraqitjen, në formën e kërkuar, të dokumentacionit shoqërues, që vërteton të dhënat që regjistrohen;

ç) faktin nëse të dhënat e shprehura në formularin e regjistrimit nuk kundërshtojnë, në mënyrë të dukshme, të dhënat që përmbajnë dokumentet, që shoqërojnë formularin;

d) faktin nëse dokumentacioni i paraqitur nuk përmban korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse, si dhe kur përmbajtja e tij nuk duket qartë, është e palexueshme apo pengon marrjen e imazhit elektronik;

dh) nëse emri i zgjedhur mund të regjistrohet;

e) pagesën e tarifës përkatëse për regjistrim;

3. Sekretaria e Regjistrimit Elektronik lëshon një konfirmim me shkrim, sipas një formati të miratuar me urdhër të Ministrisë të Drejtësisë, për çdo kërkesë të dorëzuar.

4. Konfirmimi lëshohet sipas formatit të miratuar dhe duhet të tregojë kohën e dorëzimit, numrin rendor të paraqitjes së kërkesës, objektin e kërkesës, listën e dokumenteve të dorëzuara dhe shumën e tarifës së paguar.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë merr në shqyrtim kërkesat për regjistrim, sipas radhës së paraqitjes së tyre.

6. Sekretaria e Regjistrimit është e detyruar të marrë në dorëzim çdo kërkesë, të paraqitur sipas këtij ligji dhe dokumentet që i bashkëlidhen, edhe nëse kërkesa është e paplotë, apo dokumentet shoqëruese të pasakta.

7. Regjistrimi, përpunimi, shqyrtimi i kërkesave nga Gjyqtari ose nga Kancelari si dhe ruajtja e të dhënave, të njoftuara dhe të depozituara në regjistër, kryhen nëpërmjet një sistemi të informatizuar.

#### Komente/Sugjerime

Neni 27, Paraqitja e kërkesave, është e paqartë nëse i referohet regjistrimit fillestar. Është e nevojshme të rishihet, në linjë me nenin 10 dhe komentet në të.

#### Neni 28

##### **Pezullimi i shqyrtimit të kërkesës**

1. Në rastet kur pas verifikimeve të parashikuara në nenin 27, të këtij ligji, rezulton se nuk janë përmbushur kushtet për regjistrim, nuk janë paguar tarifat përkatëse të regjistrimit, apo nuk janë kryer regjistrimet e kërkuara, sipas nenit 46, Gjyqtari ose Kancelari, sipas rastit, pezullon shqyrtimin e kërkesës dhe e njofton kërkuuesin me shkrim për shkakun e saktë të pezullimit, duke i dhënë një afat prej 21 ditësh kalendarike për plotësimin ose ndreqjen e të metave që pengojnë regjistrimin. Njoftimi i shkakut të pezullimit bëhet nëpërmjet një formulari standard, sipas formatit të miratuar me urdhër nga Ministri i Drejtësisë.

2. Nëse kërkuesi plotëson ose ndreq të metat që pengojnë regjistrimin, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është e detyruar të kryejë regjistrimin brenda një afati 5-ditor nga data e plotësimit ose ndreqjes së dokumentacionit. Në këtë rast, regjistrimi mban datën e paraqitjes së kërkesës së parë për regjistrim.

#### Neni 29

##### **Përfundimi i një gjyqtari**

1. Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga shqyrtimi i kërkesës për regjistrim ose çregjistrim në rastet e parashikuara në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile.

2. Për heqjen dorë dhe përfundimin e gjyqtarit nga shqyrtimi i kërkesës zbatohen nenet 73 dhe 74 të Kodit të Procedurës Civile.

#### Komente/Sugjerime

Është e nevojshme të ketë edhe një parashikim për të drejtën e aplikuesit për të kërkuar ndryshim të gjyqtarit që merr në shqyrtim kërkesën.

#### Neni 30

##### **Vendimi i gjyqtarit**

1. Gjyqtari, me përfundim të rasteve kur ka pezulluar shqyrtimin e kërkesës sipas nenit 28 të këtij ligji, vendos për kërkesat e regjistrimit ose të çregjistrimit, në dhomë këshillimi brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës në sekretarinë e regjistrimit ose në formë elektronike.

2. Vendimi për regjistrimin jepet nga gjyqtari edhe në rastin kur një gjykatë tjetër ka marrë vendim për kryerjen e këtij veprimi.

#### Neni 31

##### **Vendimi i Kancelarit**

Kancelari, me përfundim të rasteve kur ka pezulluar shqyrtimin e kërkesës sipas nenit 28 të këtij ligji, vendos për kërkesat për regjistrimet e tjera, sipas përcaktimit të seksionit IV të Kreut II të

këtij ligji, brenda 1 dite pune nga data e depozitimit të kërkesës në sekretarinë e regjistrit elektronik ose në formë elektronike.

#### Neni 32

### **Mospranimi i kërkesës për regjistrim**

1. Mospranimi i kërkesës për regjistrimin fillestar të organizatave jofitimprurëse në Regjistrin elektronik bëhet me vendim të gjyqtarit kompetent për Regjistrin Elektronik.

2. Mospranimi i kërkesës për regjistrimet e tjera sipas përcaktimit të seksionit IV të Kreut II të këtij ligji, bëhet me vendim të Kancelarit.

3. Kërkesa për regjistrim refuzohet refuzohet vetëm në rastet kur:

a) kërkesa nuk është në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë ligj ose në ligjin për organizatat jofitimprurëse dhe kërkuesi nuk plotëson ose ndreq elementet, që pengojnë regjistrimin brenda afatit;

b) të dhënat, që kërkohen të regjistrohen, janë të ndryshme nga të dhënat e regjistrueshme, sipas dispozitave të këtij ligji.

4. Refuzimi i njoftohet kërkuetit me shkrim, sipas formularit standard, në të cilin jepet edhe shkaku i këtij refuzimi.

5. Kundër vendimit të gjyqtarit për mospranimin e kërkesës për regjistrim fillestar mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve në Gjykatën e Apelit të Tiranës.

6. Kundër vendimit të kancelarit për mospranimin e kërkesës për regjistrimet e tjera mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve pranë Gjyqtarit kompetent për regjistrin elektronik. Në këtë rast, gjyqtari shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të ankimit. Ndaj vendimit të gjyqtarit për mospranimin e ankimit, mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

#### Neni 33

### **Përmbajtja e vendimit të regjistrimit**

Vendimi i gjyqtarit për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse ose i kancelarit për regjistrimin e të dhënave të tjera, duhet të përmbajë në mënyrë të plotë çështjet që duhet të pasqyrohen në Regjistrin Elektronik.

#### Neni 34

### **Ekzekutimi i vendimit të regjistrimit**

1. Vendimi i gjyqtarit për regjistrim ose çregjistrimin në Regjistrin Elektronik si dhe vendimi i Kancelarit për regjistrimet e tjera ekzekutohet nga Sekretaria e Regjistrit jo më vonë se 1 ditë pune nga data që vendimi ka marrë formë të prerë.

2. Menjëherë me ekzekutimin e regjistrimit, Sekretaria e Regjistrit lëshon certifikatën e regjistrimit ose vërtetimin e kryerjes së regjistrimeve të tjera.

## SEKSIONI II

### REGJISTRIMI I NJËKOHSHËM, NUMRI UNIK I IDENTIFIKIMIT, PUBLIKIMI DHE LËSHIMI I CERTIFIKATAVE



## Neni 35

### Regjistrimi i njëkohshëm

1. Regjistrimi i organizatave jofitimprurëse në Regjistrin Elektronik përbën, gjithashtu, regjistrimin e njëkohshëm të tyre pranë administratës tatimore, qendrore dhe vendore, në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe pranë inspektoratit të punës.

2. Organizatat jofitimprurëse, për qëllimet e regjistrimit e të pajisjes me certifikatën e regjistrimit fillestar, deklarojnë, gjithashtu, të dhënat e detyrueshme, sipas legjislacionit tatimor, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe atij të statistikave, sipas formularëve përkatës.

3. Me përjashtim të rasteve kur ligji shprehimisht kushtëzon nisjen e veprimtarisë përkatëse me marrjen e një lejeje, licence apo autorizimi, organizata jofitimprurëse e pajisur nga Sekretaria e Regjistrimit me certifikatën e regjistrimit fillestar ka të drejtë të nisë menjëherë veprimtarinë e saj.

#### Komente/Sugjerime

Neni 35, në pikën 2, janë të paqarta kërkesat lidhur me paisjen me certifikatë. Në momentin kur OJF nuk ka filluar aktivitetin, apo nuk i ka lindur detyrimi për t'u pajisur me numrin e identifikimit, për çfarë informacioni bëhet fjalë (tatimor, sigurime, etj).

Nuk është e mundur që një organizatë që nuk e ka fituar autoritetin ligjor (regjistrimin fillestar) të ofrojë këto të dhëna.

Është e paqartë nëse paisja me numrin e identifikimit është proces paralel me regjistrimin (fitimin e autoriteti juridik). Është po ashtu e paqartë çfarë detyrimesh tatimore lind kjo për një OJF kur ajo mund të operojë edhe vullnetarisht, pa fonde dhe staf të paguar.

Përderisa organizata nuk ka filluar të zbatojë një projekt të financuar apo të menaxhojë donacione dhe veprimtari që kanë shpenzime financiare nuk ka nevojë të ketë numër identifikimi dhe detyrime nga Inspektorati i Punës.

## Neni 36

### Numri unik i identifikimit të subjektit

1. Me regjistrimin në regjistrin elektronik, organizatave jofitimprurëse u jepet numri i identifikimit, i cili gjenerohet në mënyrë elektronike nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe është unik për çdo organizatë jofitimprurëse të regjistruar.

2. Numri unik i identifikimit të organizatës jofitimprurëse është i vlefshëm për identifikimin e organizatave, për qëllimet e regjistrimit në regjistrin elektronik, për qëllimet e regjistrimit si person i tatueshëm pranë autoriteteve tatimore, qendrore dhe vendore, për skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për autoritetet e inspektimit të marrëdhënieve të punës, si dhe për çdo qëllim tjetër statistikor ose identifikues.

3. Numri unik i identifikimit të organizatave jepet vetëm një herë, në çastin e regjistrimit fillestar dhe është i pandryshueshëm, si dhe nuk u jepet organizatave të tjera edhe pas çregjistrimit.

4. Organizatat jofitimprurëse të regjistruara janë të detyruara të shënojnë numrin unik të identifikimit të organizatës në çdo korrespondencë të tyre.

#### Komente/Sugjerime

Neni 36, i referohet numrit unik të identifikimit të subjektit. Nga karakteristikat që ka ky numër unik dhe funksionet e tij duket sikur bëhet fjalë për NUIS. Është i njëjtë në fakt? Nëse po, kjo është problematike për gjithë arsyet sesi është organizuar dhe funksionon sistemi tatimor në vend. A është diçka e tillë e mundur?

Në çdo rast mbetet e paqartë nëse flasim për dy numra të ndryshëm (Numri unik i identifikimit dhe NUIS) apo zëvendesojnë njeri-tjetrin. Në çdo rast kjo mbetet e paqartësuar në ligj sesi kryhet.

Neni 36, pika 4, përcakton detyrimin e OJF-ve të shënojnë numrin unik të identifikimit të organizatës në çdo korrespondencë të tyre. Është e paqartë për çfarë korrespondencash flasim? Edhe atë midis organizatave, donatorëve dhe jo vetëm për arsye zyrtare me institucionet? Është e nevojshme të qartësohet, gjithsesi, nëse është ky rasti, është një kërkesë e ekzagjeruar.

#### Neni 37

### **Publikimi elektronik**

1. Çdo e dhënë e regjistruar në regjistër nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit, që mbahet Sekretaria e Regjistrimit në format elektronik dhe botohet në faqen e zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Sekretaria e Regjistrimit Elektronik kryen publikimin në buletin brenda një dite nga data e kryerjes së regjistrimit. Për çdo publikim përcaktohet qartë data, në të cilën është regjistruar e dhëna e publikuar.

3. Sekretaria e Regjistrimit Elektronik për çdo ditë pune publikon në buletin të gjitha regjistrimet e kryera gjatë ditës së mëparshme.

4. Publikimi në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit përbën publikim zyrtar të regjistrimeve, të kryera në kuptim të nenit 6 të këtij ligji.

#### Komente/Sugjerime

Neni 37 përsëritet 2 herë: Neni 37. Publikimi elektronik dhe Neni 37. Çertifikata e regjistrimit fillestar.

#### Neni 37

### **Certifikata e regjistrimit fillestar**

1. Sekretaria e Regjistrimit Elektronik, brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj për regjistrimin fillestar, i lëshon organizatës jofitimprurëse të regjistruar certifikatën e regjistrimit, e cila përmban emrin, formën, numrin unik të identifikimit, datën e regjistrimit fillestar dhe selinë ose adresën e vendit kryesor të ushtrimit të veprimtarisë.

2. Në rast se organizata jofitimprurëse e regjistruar ushtron veprimtarinë në më shumë se një vend, Sekretaria e Regjistrimit Elektronik lëshon nga një certifikatë regjistrimi për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë. Këto certifikata, përveç adresës përkatëse, përmbajnë, gjithashtu, emrin, formën, datën e regjistrimit fillestar dhe numrin unik të identifikimit të organizatës jofitimprurëse.

3. Në rastet kur organizata jofitimprurëse ndryshon emrin, formën, selinë apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë, Sekretaria e Regjistrimit Elektronik zëvendëson certifikatat e lëshuara më parë me një certifikatë të re për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë. Këto certifikata, përveç adresës përkatëse, përmbajnë, gjithashtu, emrin, formën, datën e regjistrimit fillestar dhe numrin unik të identifikimit të organizatës jofitimprurëse.

4. Certifikata e regjistrimit lëshohet në një kopje origjinale për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë. Në rast humbjeje apo dëmtimi të certifikatës së regjistrimit, ajo zëvendësohet me një dublikatë të lëshuar nga Sekretaria e Regjistrimit Elektronik.

5. Organizata jofitimprurëse është e detyruar të vendosë certifikatën përkatëse në çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë, në një vend të dukshëm.

#### Komente/Sugjerime

Neni 37, pika 2, përcakton që Sekretaria e Regjistrimit Elektronik lëshon nga një certifikatë regjistrimi Kjo është konfuzuese. Mbetet i paqartë funksioni i përdorimit të këtyre certifikatave. Kush certifikatë

përdoret/prevalon në pagesat p.sh. të sigurimeve dhe tatimeve të personelit, kur dega në Shqipëri nuk ka autoritet ligjor e për rrjedhojë manaxhimi është i qendëruar?  
Në terma praktik si numërohen vendodhjet dhe degët e një organizate kur çertifikata përmban të njëjtin numer?

Neni 38

### **Vërtetime për regjistrimet**

Pas regjistrimit, sipas dispozitave të këtij ligji, Sekretaria e Regjistrimit Elektronik i lëshon subjektit një vërtetim regjistrimi, ku përcaktohen qartë veprimi i kryer dhe data e këtij regjistrimi.

Neni 39

### **Formati dhe përmbajtja**

Ministri, me propozimin e Kancelarit, miraton formatin dhe përmbajtjen e certifikatave, vërtetimeve dhe të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare të Regjistrimit, sipas këtij ligji.

Neni 40

### **Korrigjimi i gabimeve**

1. Pasaktësitë, gabimet e shtypit ose gabimet e tjera të dukshme të këtij lloji, të bëra gjatë regjistrimeve, të cilat rezultojnë qartë nga dokumentacioni i depozituar dhe nuk cenojnë vlefshmërinë e regjistrimit, mund të korrigjohen nga Sekretaria e Regjistrimit Elektronik kryesisht apo me kërkesë të personave të interesuar.

2. Ndryshimi i të dhënave të pasakta, të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një kërkesë të re për regjistrim.

3. Ndreqja e pasaktësive apo gabimeve publikohet, sipas dispozitave të nenit 37 të këtij ligji.

4. Kërkesa për ndreqje të gabimeve kryhet pa pagesë.

## **KREU V**

### **AKSESI PUBLIK DHE EKSTRAKTET**

Neni 41

### **Kërkimet në bazën e të dhënave**

Çdo person i interesuar mund të kryejë, sipas këtij ligji, pa pagesë, kërkime në bazën e të dhënave elektronike për çdo të dhënë të regjistruar, me përjashtim të adresës së banimit të individëve.

### **Komente/Sugjerime**

Mungon një strukturë bazë e regjistrimit. Përcaktimi “baza e të dhënave elektronike”, është konfuzues dhe i pasaktë. Është e nevojshme të qartësohet dhe përshkruhet më i detajuar.

Neni 42

### **Ekstraktet e regjistrimit elektronik**

1. Sekretaria e Regjistrimit Elektronik konfirmon të dhënat e regjistruara nga organizatat

jofitimprurëse, sipas këtij ligji, nëpërmjet lëshimit të ekstrakteve në format shkresor apo elektronik, sipas këtij ligji. Çdo person, kundrejt pagesës së tarifës përkatëse, ka të drejtë të marrë pa pengesa, në format shkresor apo elektronik, sipas dëshirës, ekstrakte për të dhënat e regjistruara të çdo organizate jofitimprurëse, si dhe kopje të dokumenteve shoqëruese, të depozituara në regjistër.

2. Ekstraktet mund të lëshohen për të dhëna të caktuara të organizatave jofitimprurëse si dhe për historikun e veprimeve të kryera nga një organizatë jofitimprurëse.

3. Ministri, me propozimin Kancelarit, miraton formatin e ekstrakteve dhe të kërkesës për lëshimin tyre.

#### Komente/Sugjerime

Sipas Nenit 41, pika 1, ligji duhet të përcaktojë natyrën e informacionit që mund të tërhiqet nga publiku. Kjo mund të rregullohet me një format të përcaktuar siç ndodh dhe në rastin e biznesit (ekstrakti) që është edhe publik në fakt e s'ka nevojë për kërkesë.

Është e paqartë se si bëhet pagesa në një rast të tillë të marrjes së informacionit elektronik?

Një procedurë aplikimi nëpërmjet sistemit elektronik duhet të jetë në çdo rast pa pagesë dhe mund të rregullohet nga sistemi që të jetë edhe automatike duke përcaktuar listën e subjektive të autorizuara për ta kërkuar një informacion të tillë në emër të organizatës.

Lidhur me Nenin 41, pika 2, është e paqartë pse duhet të flasim për kopje të pavërtetuara? Çdo informacion i depozituar është bërë sipas një procedure dhe në këtë rast përgjegjesinë për informacionin e mban deklaruesi. Për më tepër ky ligj parashikon edhe sanksione për deklarime të rreme.

#### Neni 43

##### **Vërtetimi i ekstrakteve dhe i dokumenteve shoqëruese**

1. Ekstraktet dhe kopjet e dokumenteve shoqëruese në format shkresor, si rregull, lëshohen nga Sekretaria e Regjistrimit Elektronik, si kopje e vërtetuar e të dhënave të regjistruara apo të dokumenteve shoqëruese përkatëse, përveç rastit kur personi i interesuar heq dorë nga marrja e këtij vërtetimi.

2. Ekstraktet dhe kopjet e dokumenteve shoqëruese në format elektronik, si rregull, lëshohen nga Sekretaria e Regjistrimit Elektronik si kopje e pavërtetuar e të dhënave të regjistruara apo të dokumenteve shoqëruese përkatëse, përveç rastit kur personi i interesuar shprehimisht kërkon ta marrë këtë vërtetim.

#### Neni 44

##### **Komunikimi elektronik me autoritete të tjera publike**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për të garantuar lehtësimin e procedurave të regjistrimit dhe ofrimin e shërbimeve të tjera shtesë, në favor të subjekteve të interesuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi, bashkëpunon me autoritete të tjera publike dhe mundëson ndërlidhjen dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave, të regjistruara në bazën e saj elektronike, me regjistra apo baza të dhënash elektronike të autoriteteve të tjera publike, si brenda, ashtu dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### Komente/Sugjerime

Ngritja e gjithë sistemit elektronik mbi parimin e shkëmbimit të informacionit dhe jo të qenurit pjesë e

të njëjtë sistem ku të dhënat aksesohen nga institucionet e përcaktuara, do të sjellë për sektorin detyrimin e raportimit të shumëfishtë në disa institucione.

Nëse propozimi do të çojë në trajtimin e regjistrimit si një pikë fokale ku do të kryhet i gjithë raportimi, kjo është e nevojshme të qartësohet e saktësohet në këtë draft ligj, ndonëse drafti nuk të jep përshtypjen që ka këtë lloj qëllimi nga ana e propozuesve.

Nëse do të marrim të mirqenë që sistemi garanton shkëmbimin dhe aksesin e informacionit me Institucione të tjera atëherë për logjikë nuk ka pse të kërkohet që të publikohen në regjister pasqyrat financiare sepse ato mund të merren nga tatimet. Duhet bërë një ndarje e qartë e procedurës së regjistrimit të OJF-ve me pjesën e menaxhimit dhe kontrollit të veprimtarisë së tyre që nuk mund të jetë objekt i këtij ligji.

## KREU VI SPORTELI ELEKTRONIK

### Neni 45

#### **Veprimet pranë sportelit elektronik**

1. Çdo shtetas, pasi të jetë identifikuar elektronikisht, ka të drejtë që, në cilësinë e kërkuesit apo të personit të autorizuar, të paraqesë një kërkesë për regjistrim apo të kryejë pranë sportelit elektronik çdo regjistrim apo veprim tjetër, sipas këtij ligji, përfshirë këtu procedurën e ankimit ndaj vendimit të Kancelarit sipas nenit 32 të këtij ligji, dhe të marrë nga Sekretaria e Regjistrimit Elektronik nëpërmjet këtij sporteli të gjitha aktet përkatëse të parashikuara nga ky ligj.

2. Çdo shtetas, pa qenë i detyruar të identifikohet elektronikisht, ka të drejtë të kryejë pranë sportelit elektronik kërkime elektronike në regjister, të marrë ekstrakte, si dhe kopje të dokumenteve shoqërues në format elektronik apo të kryejë veprime të tjera, për të cilat identifikimi i personit ose kryerja e pagesës së një tarife nëpërmjet mjeteve elektronike, nuk kërkohet sipas këtij ligji.

### Neni 46

#### **Identifikimi elektronik**

Veprimet pranë sportelit elektronik të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilat ky ligj kërkon identifikimin elektronik, kryhen nëpërmjet mjeteve elektronike që garantojnë autenticitetin e origjinës dhe pacenueshmërinë e përmbajtjes së dokumenteve në format elektronik, të paktën nëpërmjet nënshkrimit elektronik të avancuar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik.

### Neni 47

#### **Kushtet procedurale dhe teknike**

Këshilli i Ministrave përcakton kushtet, afatet dhe procedurat për ofrimin shërbimeve nga Sekretaria e Regjistrimit Elektronik, sipas këtij ligji, nëpërmjet sportelit elektronik, kushtet dhe mënyrat e pajisjes së individëve me të drejtat përkatëse të aksesit elektronik, procedurat për ndryshimin e tyre, kushtet e sigurisë dhe të ruajtjes së komunikimeve elektronike, mënyrat e vërtetimit të dokumenteve elektronike, të lëshuara nga Sekretaria e Regjistrimit Elektronik, të kërkesave e teknologjisë së zbatueshme për realizimin e tyre, sipas këtij kreu, si dhe procedurat e njoftimit publike, të realizuara nga Sekretaria e Regjistrimit Elektronik për rastet e remonteve të planifikuara apo të incidenteve teknike të sportelit elektronik, si dhe për njoftimin e rasteve të ndërhyrjeve të paautorizuara.

KREU VII  
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 48

**Kundërvajtjet administrative**

1. Organizata jofitimprurëse si dhe personat e autorizuar për të bërë regjistrimin janë përgjegjëse sipas ligjeve në fuqi, për vërtetësinë e fakteve, të të dhënave të njoftuara dhe të dokumenteve shoqëruese, të depozituara në regjistrin elektronik.

2. Deklarimi në regjistrin elektronik i të dhënave të pavërteta, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë.

3. Moskryerja e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë.

4. Gjoha vendoset nga Kancelari, vendimi i të cilit ankimohet drejtpërdrejt në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Komente/Sugjerime

Neni 48, pika 3, në lidhje me tejkalimin e afatave të regjistrimit fillestar, është e paqartë se përse përbën kundërvajtje. Regjistrimi është çështje e vullnetit të lirë të themeluesve dhe çdo tejkalim afatesh në këtë drejtim nuk duhet parë si shkelje, për aq kohë sa nuk sjell asnjë pasojë.

KREU VIII  
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 49

**Regjimi tranzitor dhe aktet nënligjore**

1. Regjistrimet e kryera përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të vlefshme vetëm nëse përmbushen kushtet e përcaktuar nga neni 11 i këtij ligji.

2. Administrata tatimore, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i jep Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjitha të dhënat, që ato disponon për subjektet e regjistruara pranë tyre.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi përditëson regjistrin elektronik me të dhënat e nevojshme dhe njofton subjektet, për plotësimin e dokumentacionit, nëse konstatohet se dokumentacioni i administruar kërkon përditësim, në përmbushje të detyrimeve për regjistrimi sipas nenin 11 të këtij ligji.

4. Organizatat jofitim prurëse, kanë detyrimin të bashkëpunojnë me Gjykatën e rrethit Gjyqësor Tiranë, në plotësimin e të dhënave të nevojshme në përmbushje të kërkesave të këtij ligji për regjistrimin fillestar dhe mos përmbushja e kërkesave të këtij ligji passjell çregjistrimin e tyre nga regjistrimi i orgnaizatave jofitim prurëse me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Komente/Sugjerime

Neni 49, pika 2, përcakton që administrata tatimore brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, i jep Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjitha të dhënat, që ajo disponon për subjektet e regjistruara pranë tyre.

Është e paqartë për çfarë të dhënash bëhet fjalë. Nënkupton kjo një transferim total të përgjegjësisë së mbajtjes së rekordeve vetëm nga gjykata? Kush duhet parë që këtë e tutje si institucioni përgjegjës për sektorin?

Është e paqartë se çfarë ndodh me NUIS të organizatave që janë të pajisura me një të tillë tashme. I paqartë po ashtu është dhe afati që ka gjykata që ti pajisi OJF-të ekzistuese me çertifikatën e re. Është e paqartë çfarë detyrimi i lind kjo OJF-ve ekzistuese lidhur me tatim taksat, sigurimet shoqërore në përditësimin e informacionit me ta.

Regjimi tranzitor duhet ripare me kujdes sidomos për OJF ekzistuese qofshin ato aktive apo pasive.

Është e paqartë se si do të mundet Gjykata të përditësojë të dhënat me njoftim paraprak, ndërkohë kur ajo nuk disponon adresa kontakti të OJF-ve, mbi të gjitha për një pjesë të mirë të tyre që s'janë të regjistruara as në tatim taksa. Kjo është një çështje e rëndësishme që duhet menduar, sidomos kur ligji parashikon penalitete siç është ç' regjistrimi, një shkelje e rëndë e të drejtës së organizimit.

Neni 39, pika 4 përcakton që mos përmbushja e kërkesave të këtij ligji passjell çregjistrimin e tyre nga regjisitri i orgnaizatave jofitim prurëse me hyrjen në fuqi të këtij ligji. A nënkupton kjo shkrirjen e OJF-ve? Ç' regjistrimi i një OJF sipas kodit Civil (n.52 &62), Ligjit nr. 8781 "Për Organizatat Jofitimprurëse", por edhe këtij drafti (Neni 24), bëhet vetëm në rastet e përcaktuara në ligj dhe me proces gjyqësor. Ky nen është shkelje flagrante e të drejtës së organizimit.

Po ashtu është e nevojshme të qartësohet si ndodh ç' regjistrimi se si mund të jetë automatik dhe ndoshta do rishikim dhe në nenin 20, pika 2, gërma c:

Ç' regjistrimi kryhet:

- a) në mënyrë vullnetare me iniciativën e vetë organizatës jofitimprurëse;
- b) në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë;
- c) sipas parashikimit të ligjeve të posaçme.

Gjithashtu ç' regjistrimi me hyrjen në fuqi të ligjit, i bie të ketë efekt prapaveprues, sepse mosplotësimi i dokumenteve ndodh më vonë p.sh. sipas pikes 3 më lart, kur Gjyakta brenda 6 muajsh kërkon plotësim dokumentesh pas ndërtimit të regjistrit.

Neni 50

### **Shfuqizime**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 8789, datë 7.5.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse", dhe aktet ligjore e nënligjore që bien në kundërshtimi me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 51

### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.